



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**VENDIM**

**Nr.293, datë 06.07.2021**

**PËR  
NGRITJEN E GRUPIT TË PUNËS PËR HARTIMIN E UDHËZUESIT STANDARD TË  
SHTYPIT**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të neneve 147 dhe 147a të Kushtetutës dhe të nenit 91, pika 1, paragrafi “ç”, të Ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”,

**VENDOSI:**

1. Ngritjen e Grupit të Punës për hartimin e Udhëzuesit Standard të Shtypit.
2. Grupi i Punës përbëhet nga tre anëtarë, një anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe dy Gjyqtare për Mediat, si më poshtë:
  - Erjon Muharremaj - Anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor;
  - Saida Dollani - Gjyqtare për Mediat për juridiksionin e Apelit për gjykimin e veprave penale të krimit të organizuar dhe korrupsionit;
  - Edlira Petri - Gjyqtare për Mediat për juridiksionin e Apelit Tiranë.
3. Në përmbushje të detyrave të tij sipas pikës 1, Grupi i Punës kryen analizën e kuadrit ligjor në fuqi dhe të standardeve të Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës, përfshirë praktikën gjyqësore respektive, në lidhje me komunikimin e gjykatave me publikun dhe median, si dhe bashkëpunon me këshillat e gjykatave, kryetarët, kancelarët dhe nëpunësit civilë gjyqësorë për marrëdhëniet me publikun dhe me Misionin EURALIUS V.
4. Grupi i Punës ushtron veprimtarinë e tij deri në hartimin e Udhëzuesit Standard të Shtypit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**